

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-220/15

**Prishtinë,
16 Maj 2018**

Në çështjen juridike të:

D. B. Đ.

Pala ankuese

kundër

Askush

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Ragip Namani, anëtarë, duke vendosur rreth ankesës kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/260/2014 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA28128), të datës 21 tetor 2014, pas shqyrtimit të mbajtur më 16 Maj 2018, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e D. Đ. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/260/2014 (për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA28128), të datës 21 tetor 2018.
2. Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/260/2014 për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA28128, të datës 21 tetor 2018.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 28 shkurt 2008, D. Đ. (në tekstin e mëtejme: pala ankuese), ka paraqitur një kërkesë (në emër të nënës së tij V. Đ.), në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) duke kërkuar ri-posedimin e ngastrës kadastrale nr. 402/10 me kulturë, tokë kultivuese e klasës së 6-të, me sipërfaqe prej 04.76.36 ha. Ngastra kadastrale nr. 402/10, ndodhet në Komunën e Ferizajt, Zona Kadastrale e Nekomides (në tekstin e mëtejme: prona e kërkuar). Paraqitësi i kërkesës ka deklaruar se posedimi i pronës së kërkuar ishte humbur më 12 qershor 1999 për shkak të konfliktit të armatosur gjatë viteve 1998/1999 dhe është uzurpuar në mënyrë të paligjshme nga N. B.
2. Për ta mbështetur kërkesën e tij, ai ka dorëzuar në AKP, këto dokumente:
 - Certifikatën e martesës nr. 484 të lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Civil në Ferizaj më 20 maj 1987, që tregon se pala ankuese është i biri i V. Đ,
 - Procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor, të hartuar më 5 dhjetor 1995, nga Gjykata Komunale e Ferizajt, me ç' rast anulohet kontrata e shitblerjes e vërtetuar në Gjykatën Komunale të Ferizajt, nën numrin Ov.Br.945/62, me datë 12 dhjetor 1962, dhe e lidhur në mes të ndjerit, babait të V. Đ., në cilësinë e shitësit dhe Kooperativës Bujqësore. NSH Poljuprirodno Dobro në Ferizaj është urdhëruar që t'ia kthejë Vida Đorđević posedimin e pronës së kërkuar,
 - Vendimin Kadastral nr. 952-01-1/97-210, të lëshuar Drejtoria për Gjeodezi e Republikës së Serbisë më 2 dhjetor 1997 me të cilin, V. Đ. i është aprovuar

ndryshimi i shfrytëzuesit në emër të saj, në regjistrin kadastral për pronën e kërkuar, e cila deri në datën e lëshimit të Vendimit ishte regjistruar në pronësi shoqërore (në tekstin e mëtejme “NSH”)- Kombinat Mladost) nga Ferizaj. Bazë ligjore e ndryshimeve kadastrale u përdor Vendimi nr. 188/97 i lëshuar nga Gjykata Komonale në Ferizaj më 26 korrik 1997,

- Fletë poseduese nr. 416, të lëshuar nga Zyra e Gjeodezisë Qendra për Kadastër dhe të Drejta të Pronës së Paluajtshme të Republikës së Serbisë (kadastru i zhvendosur) më 18 qershor 2001, ku prona e kërkuar është e regjistruar në emër të V. Đ.,
 - Deklaratën me shkrim të V. Đ., ku ajo ka deklaruar se prona e kërkuar nuk është shitur asnjëherë nga ajo ose nga anëtarët e familjes së saj, dhe ende është e regjistruar në emër të saj. Sipas saj, një pjesë e pronës së kërkuar ishte uzurpuar nga N. B., dhe nëse N., në rast se posedon ndonjë dokument në lidhje me pronën e kërkuar, ato dokumente janë të falsifikuara.
3. Më 28 maj 2010, AKP-ja bëri njoftimin e kërkesës duke e publikuar në Gazetën e Njoftimit nr. 1 dhe në Buletinin e Zyrës për Prona të UNHCR-it. Gazeta dhe lista iu lanë kryesuesit të fshatit Nekodim, i cili ra dakord që t’ia dorëzojë palëve të interesuara. Të njëjtat publikime janë lënë edhe në Komunë, Zyre Kadastrale dhe Gjykatë Komonale të Ferizajt. Korrektësia e njoftimit është vërtetuar më 1 qershor 2010.
 4. Brenda afatit ligjor prej 30 ditëve, në pajtim me dispozitat e nenit 10.2 të Ligjit nr. 03/L-079, asnjë palë nuk ka shprehur ndonjë interes për të marrë pjesë në procedurë lidhur me pronën që është objekt i kërkesës; pasi që asnjë palë nuk e ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës, e njëjta mbeti e pakontestueshme.
 5. Vendimi Kadastral nr. 952-04/97-250, nuk u gjet në Kadastër të Komunës së Ferizajt dhe në kadastrin e zhvendosur në Krushevc, kështu që verifikimi i të njëjtit dokument rezultoi negativ. Sa i përket Fletës Poseduese, është vërtetuar nga Kadastri Komunal së Ferizajt. Sipas raportit të verifikimit, prona e kërkuar është gjetur e regjistruar në emër të N. B. Historiku kronologjik i ndryshime është përshkruar si në vijim:
 - prona e kërkuar ishte e regjistruar në emër të NSH “Kooperativa Bujqësore-Mladost. Pas Vendimit nr. 1986/92, të lëshuar nga Gjykata Komonale në Ferizaj, më 17 korrik 1995 dhe Vendimit nr. 51/07, të lëshuar nga Gjykata Komonale në Ferizaj, më 27 korrik 2002, prona është bartur në emër të N. B. Pastaj nga N.B, prona e kërkuar është bartur në emër të I. B., sipas Aktvendimit për trashëgiminë nr. 152/02, të lëshuar nga Gjykata Komonale në Ferizaj,

më 31 korrik 2003, dhe përfundimisht përmes kontratës së shitblerjes të vërtetuar në Gjykatën Komunale të Ferizajt, me numër Vr.Nr.1761/03, prona e kërkuar është bartur në emër të N.B.

Kadastr i zhvendosur në Krushevc e ka verifikuar pozitivisht Fletën Poseduese, duke thënë se ndryshimet në regjistrin kadastral janë bërë në pajtim me Vendimin nr. 188/97 të lëshuar më 8 tetor 1997, por i njëjti Kadastër i zhvendosur e ka verifikuar negativisht Vendimin nr. 188/97, i cili supozohet të ishte baza ligjore e ndryshimeve të lartpërmendura.

6. Pala ankuese është informuar (më 20 gusht përmes telefonit) lidhur me rezultatet e verifikimit të dokumenteve të dorëzuara nga ai në mbështetje të kërkesës së tij (shih faqe nr. 146 të dosjes së lëndës).
7. Si përpjeke shtesë, Sekretaria Ekzekutive e AKP-së, më 26 mars 2013, ia dërgoi palës ankuese një shkresë mbi njoftimin e refuzimit potencial të kërkesës, duke kërkuar nga ai dorëzimin e dëshmime shtesë të cilat vërtetojnë të drejtën pronësore të nënës së tij brenda afatit prej 30 ditëve. Paraqitësi i kërkesës e ka pranuar shkresën, megjithatë, nuk parashtroi përgjigje dhe nuk ka ofruar asnjë provë (shih faqe 234 të dosjes së lëndës).
8. Me vendimin e saj, KPCC/D/A/260/2014, të datës 21 tetor 2014, KKPK-ja e ka refuzuar kërkesën duke u bazuar në atë se pala ankuese nuk e ka dëshmuar pronësinë apo ndonjë të drejtë tjetër prone ndaj pronës së kërkuar, para ose gjatë konfliktit të viteve 1998-1999.
9. Vendimi i është dorëzuar palës ankuese më 23 shkurt 2015. Ai ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme më 23 mars 2015.

Pretendimet e palës ankuese

10. Pala ankuese pretendon se Vendimi i KKPK-së bazohet në vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Në vazhdim, pala ankuese ka pretenduar se pronësia ndaj pronës së kërkuar është dëshmuar përmes Marrëveshjes gjyqësore nr. 221/95, të datës 5 tetor 1995, Vendimit Kadastral nr. 952-01-1/97-210, i vitit 1997, Fletës Poseduese nr. 416, të datës 18 qershor 2001, të lëshuar nga shërbimi kadastral i zhvendosur, e cila paraqet një gjendje të së drejtës të pronës së paluajtshme nga viti 1999. Sipas palës ankuese është e pamundur që Fleta Poseduese nuk është verifikuar kur i njëjtit dokument ekziston në të dhënat e shërbimit kadastral të zhvendosur nga Kosova. Gjithashtu sipas palës ankuese është absolutisht jo e vërtetë që ndonjë dokument i cili paraqet bazë për regjistrimin

e pronës së lartpërmendur, nuk ka mundur të gjendet, pasi që ato dokumente më janë lëshuar mua nga i njëjti institucion.

11. Në fund të ankesës, pala ankuese e ka bërë një prezantim të hollësishëm të dëshmive që ai i ka dorëzuar me qëllim që ta vërtetojë të drejtën e pronës dhe i propozon Gjykatës Supreme që ta miratojë kërkesën në favor të tij.

Arsyetimi ligjor

Pranueshmëria e ankesës

12. Ankesa është paraqitur brenda 30 ditëve, siç është paraparë me nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079. Gjykata Supreme ka juridiksion ndaj ankesave kundër Vendimit të KKPK-së. Ankesa është e pranueshme.

Meritat e ankesës

13. Gjykata Supreme e Kosovës e ka shqyrtuar ankesën në pajtim me dispozitat e nenit 194 të LPK-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve në ankesë, ka konstatuar se ankesë është e pabazuar.
14. KKPK-ja e ka bazuar Vendimin e vet në faktin që Sekretaria Ekzekutive e AKP-së dhe KKPK-ja i ka verifikuar negativisht dokumentet në të cilat pala ankuese e bazon kërkesën e tij për pronësinë. Sekretaria Ekzekutive e KKPK-së nuk ka mundur të sigurojë *ex officio* ndonjë provë që mbështeste kërkesën e palës ankuese. Në bazë të kësaj, KKPK-ja ka konstatuar se ai nuk ka arritur të vërtetojë ndonjë të drejtë pronësore ndaj pronës kontestuese.
15. Një referim i veçantë i vendimit të KKPK-së është bërë në paragrafët 58-60 të Vendimit KPCC/D/A/260/2014. Sipas KKPK-së, pala ankuese ka dorëzuar një Marrëveshje gjyqësore të vitit 1995, si dhe Vendimin Kadastral të vitit 1997, përmes së cilit ai pretendon se e drejta pronësore ndaj pronës së kërkuar ishte bartur te nëna e palës ankuese.

16. E drejta e pronës mund të fitohet me vet ligjin, në bazë të akteve ligjore (bartjes ligjore) ose trashëgimisë, neni 20 i Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore (GZ RSFJ, Nr. 6/1980), i zbatueshëm në kohën e bartjes së pretenduar të pronës.
17. Pala ankuese e bazon kërkesën e tij në procesverbalin nga shqyrtimi gjyqësor, i hartuar më 5 dhjetor 1995, nga Gjykata Komunale e Ferizajt dhe në Vendimin Kadastral nr. 952-01-1/97-210, të lëshuar nga Drejtoria për Gjeodezi e Republikës së Serbisë, më 2 dhjetor 1997. Megjithatë, këto dokumente nuk kanë mundur të verifikohen as nga Gjykata Komunale e as nga Kadastru Komunal i Ferizajt, dhe as nga institucionet e zhvendosura të Republikës së Serbisë.
18. Sipas nenit 33 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore (GZ RSFJ, Nr. 6/1980), në bazë të akteve ligjore (bartja ligjore) e drejta pronësore mbi pasurinë e patundshme do të fitohet me regjistrimin në "librat e noterit publik" (libra kadastral) apo në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme që parashihet me ligj.
19. Ankuesi paraqet Fletën Poseduese nr. 416 të lëshuar nga Kadastru i zhvendosur i Krushevcit/Serbi, më 18 qershor 2001, duke renditur pronën e kërkuar në emër të nënës së tij.
20. Sekretaria Ekzekutive ka gjetur ex officio një Certifikatë të Drejtave të Pronës së Paluajtshme që rendit pronën në emër të një pale të tretë.
21. Është e qartë se ekziston një mospërputhje midis të dhënave në zyrën kadastrale në Ferizaj dhe atyre në arkivat kadastrale për Ferizajn të zhvendosura në Serbi.
22. Kjo çon në përfundimin se familja e palës ankuese nuk e ka fituar të drejtën e pronës pasi që kushtet e nenit 33 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore (RSFJ, nr. 6/80) nuk ishin përmbushur.
23. Kjo shpie në përfundimin se nëna e palës ankuese kurrë nuk e fitoi të drejtën e pronës pasi që Vendimi Kadastral Nr. 952-01-1/97-210 i lëshuar nga Drejtoria për Gjeodezi e Republikës së Serbisë më 2 dhjetor 1997, nuk u ekzekutua asnjëherë ashtu siç ishte specifikuar, kështu që, kushtet e nenit 33 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore (RSFJ, Nr. 6/1980), nuk janë plotësuar.
24. Gjykata Supreme konstaton se KKPK-ja ka marrë një vendim të drejtë, bazuar në një procedurë të saktë dhe korrekte. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme gjen se nuk është bërë asnjë shkelje e së drejtës materiale apo vërtetim jo i plotë i fakteve. Gjykata Supreme e konstaton ankesën të pabazuar.

25. Në bazë të mësipërmes dhe në pajtim me nenin 13.3 nën (c) të Ligjit nr. 03/L-079, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore:

Në pajtim me Ligjin nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit

Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it

Ragip Namani , Gjyqtar

Timo Eljas Torkko, Referent i EULEX-it